

Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin e **Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Projektimit dhe Zbatimit të Kontratave Ndërtimore** një kandidat profesionist, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

Arsimimi	<ul style="list-style-type: none">• Të ketë përfunduar arsimin e lartë për Inxhinieri Naftë/Ekonomik/Juridik, në universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja;
Eksperiencë pune	<ul style="list-style-type: none">• Preferohet të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në profesion.• Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm.
Cilësitë	<ul style="list-style-type: none">• Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre;• Kanë avantazh kandidatet që zotërojnë gjuhën angleze;• Aftësi për të kryer shumë detyra dhe për të përmbushur afatet;• Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikim me gojë/shkrim, të jetë i përshtatshëm për të punuar në grup, si dhe i hapur ndaj sfidave të ndryshme që mund të lindin nga procesi i punës;• Nivel i lartë integriteti, besueshmërie dhe orientimi të rezultateve;• Njohuri të mira të programeve kompjuterike që lidhen me profesionin;

Kandidatet që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që dëshirojnë të aplikojnë duhet të dërgojnë kërkesën e tyre, së bashku me CV; Fotokopje e Diplomës; Fotokopje e librezës së punës, dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. ose në adresën bnj@albpetrol.al

Kërkesat pranohen deri më datën 06.07.2020, ora 16:00.

Personat e përzgjedhur do të kontaktohen nga shoqëria Albpetrol sh.a.